



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:142065

Datë: 23.08.2024

Numri i dokumentit: 06080702

P.nr.309/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Benita Berisha, me zyrtarin ligjor Besart Mustafa, në çështjen penale kundër të pandehurit: M.T., për shkak të veprës penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje:KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.243/23 e datës 26.06.2023, duke vendosur lidhur me Marrëveshjen e Ndërmjetësimit; ND.nr.1294/2024, të datës 16.08.2024, të lidhur në mes të pandehurit: M.T. dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar KEDS – V.L., jashtë seancës e në mbështetje të nenit 357 par.1 nën par.1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPP), dhe në mbështetje të nenit 2 par. 2, nenit 8, dhe nenit 15 par. 1 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, me datë 23.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit; ND.nr.1294/2024, të datës 16.08.2024, e lidhur në Zyrën e Ndërmjetësimit pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në mes palëve, të pandehurit: M.T., në njërën anë dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar KEDS – V.L. në anën tjetër.

II.HEDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.243/23 e datës 26.06.2023, dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit:

M.T., nga i ati B....., e ëma Rr....., e vajzërisë M....., i lindur me datë 23.04.1980 në Mitrovicë, me vendbanim në Shipol, rr. "...", Mitrovicë, me numër personal:, i martuar, baba i fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

III.Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II. nr.243/23 e datës 26.06.2023, ndaj të pandehurit: M.T., për shkak të veprës penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 09.07.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën seancë kanë prezentuar: Prokurori i Shtetit Albana Parduzi, i pandehuri M.T. dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar KEDS – V.L..

Gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, i pandehuri M.T. ka propozuar që kjo çështje penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit pasi që është i gatshëm të arrij marrëveshje me palën e dëmtuar dhe është i gatshëm ta paguaj dëmin të cilin e ka shkaktuar.

Po ashtu, përfaqësuesi i palës së dëmtuar KEDS – V.L., deklaroi se, si palë e dëmtuar, sa i përket propozimit të të pandehurit, një propozim të tillë nuk e kundërshtojmë dhe të njëjtit i japim mundësi që këtë çështje penale – juridike, ta zgjedhim në procedurën alternative siç është procedura e ndërmjetësimit.

Prokurori i Shtetit A... P.... deklaroi se, pajtohet që rasti të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, pasi që plotësohen kushtet ligjore si dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar u pajtua që ky rast të zgjedhet në ndërmjetësim.

Pas dhënies së pëlqimit nga ana e palëve në procedurë, lidhur me referimin e kësaj lënde në procedurë të ndërmjetësimit, Gjykata konform dispozitave ligjore të ligjit për Ndërmjetësim, këtë çështje penale e referoi në procedurë të ndërmjetësimit.

Me datën 16.08.2024 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë është arritur Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.nr.1294/2024, në mes palëve në procedurë dhe atë të pandehurit: M.T. dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar KEDS – V.L., të cilën marrëveshje gjykata e ka pranuar me datë 21.08.2024. Të dy palët kanë deklaruar se këtë marrëveshje e kanë arritur me vullnet të plotë dhe pa asnjë presion.

Andaj Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 2 par.2, dhe nenit 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Gjykata, pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale është arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, sipas Ligjit për Ndërmjetësim, dhe aprovimit të kësaj marrëveshje nga ana e Gjykatës duke u mbështetur në nenin 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, Gjykata konstaton se kjo është një rrethanë e cila e pengon ndjekjen e mëtejme penale dhe mbi bazën e këtyre arsyeve

e duke u bazuar në nenin 357 par. 1 nën par.1.3 të KPP-së, vendosi që të hedhë akuzën dhe të pushojë procedurën penale ndaj të pandehurit M.T..

Konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim në datën e aprovimit të kësaj marrëveshje nga gjykata, përkatësisht nga data 23.08.2024, do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 453 par.1 të KPP-së, pasi që është pushuar procedura penale, ndërsa që i pandehuri i ka paguar vetë shpenzimet e ndërmjetësimit në atë procedurë.

Nga sa u tha më lartë dhe konform nenit 357 par. 1 nën par.1.3 të KPP-së, e lidhur me nenin 2 dhe nenin 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.309/23, datë: 23.08.2024

G j y q t a r j a:
Benita Berisha

KËSHILLË JURIDIKE; Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Numri i lëndës: 2023:142065
Datë: 23.08.2024
Numri i dokumentit: 06080702